



**Krijo të ardhmen tënde!**

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË  
KUVENDI I KOMUNËS PEJË  
GJIMNAZI "CAMBRIDGE"

NR. 5015  
DATA. 28.08.2020

## **PLANI I VEPRIMIT**

**për organizimin e mësimit në "Gjimnazin Cambridge"**

**gjatë pandemisë COVID-19**

Pejë, Gusht 2020



+383 44 138 336  
+383 49 554 500



info@gjimnazicambridge.com  
www.gjimnazicambridge.com



Rr. Muharrem Mitrovica  
pn. 30 000 Pejë



**Krijo të ardhmen tënde!**

## **Plani i Veprimit për organizimin e mësimin në “Gjimnazin Cambridge” gjatë pandemisë COVID-19**

### **Parimet e përgjithshme**

Menaxhment i “Gjimnazit Cambridge” është i përkushtuar në organizimin e procesit mësimor për vitin e ri shkollor 2020/21, konform të gjitha rekomandimeve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, si dhe institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e situatës me pandeminë e COVID-19.

Shëndeti i nxënësve, mësimdhënësve, stafit administrativ dhe stafit tjetër është jetik, prandaj, do të merren të gjitha masat për kujdes maksimal dhe ruajtje të shëndetit.

Institucioni ynë do të themeloj një trupë mbikqyrëse dhe koordinuese për zbatimin e masave, të cilit do të jenë në kontakt të vazhdueshëm përbrenda institucionit, si dhe me institucionet komunale dhe qendrore, ato arsimore dhe shëndetësore.

Për të qenë sa më efikas në arritjen e qëllimit kryesor, nxënien e dijes, por me shëndet të plotë, do të jemi në komunikim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me prindërit, por duke respektuar rekomendimet që ata të mos futen në shkollë.

Thirrja jonë kryesore do të jetë mbajtja e maskës gjatë gjithë kohës, ruajtja e distancës minimum prej 1.5 metrave dhe higjiena personale e secilit. Këto veprime të thjeshta, do të garantojnë suksesin e shkollës tonë në mësim dhe në betejën me pandeminë botërore.

Në anën tjetër, shkolla do të angazhohet në plotësimin e të gjitha kërkesave tjera, të respektimit të distancës, higjienës në klasë dhe ambientet tjera të shkollës dhe kontrollit shëndetësor, pastrimit dhe dezinfektimit, sipas Udhëzuesit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/21 në rrethanat e pandemisë.

Masat e përcaktuara në udhëzues janë kuptueshme dhe me to duhet të pajtohen nxënësit, personeli dhe prindërit.



+383 44 138 336  
+383 49 554 500



info@gimnazicambridge.com  
www.gimnazicambridge.com



Rr. Muharrem Mitrovica  
pn. 30 000 Pejë

## Krijo të ardhmen tënde!

### Korniza e Planifikimit

Konform udhëzuesit të MASH ku përcaktohen skenarët e organizimit të mësimit sipas niveleve të rrezikshmërisë, shkolla është e gatshme ta implementojë secilin skenar.

**SKENARI A:** Për zbatimin e Skenarit A shkolla përgaditet dhe merr masat si në vijim:

- **Higjiena:** Sigurohet i mjaftueshëm dhe masa të mjaftueshme higjienike. Pastrimi, ajrosja dhe furnizimi me sapun dhe mjete higjienike është siguruar nga shkolla;
- **Dezinfektimi:** Dhkolla dezinfektuahe nga ndëramprrje profesionale rregullisht. Janë blerë pajisejt dhe dezinfektues për dezinfektim ditor pas mbarimit të mësimit. Janë vendosur dezinfektues nëpër korridor të shkollës ku nxënësit dhe arsimtarët kanë qasje tërë kohën;
- **Klasët:** Klasët përgaditen sipas kërkesa institucionale duke ruajtur distancën dhe higjienln. Janë përgaditur klast duke respektuar distancën dhe janë siguruar bankat individuale për secilin nxënës në menyrë që të mos ketë hapërsira të përbashkëta të nxënësve. Klasat ajrosen pas çdo ore dhe mësimdhënësit qëndrojnë tërë kohën me nxënës. Mësimdhënësi dorëzon orën vetëm pasi të vije një kolegë tjetër për ta ndërruar. Klasat pranojnë prej 13 - 20 nxenës. Klasat janë të pajisura edhe me mjete audiovizuale;
- **Ushqimi:** përcaktohet orari i ushqimit duke marrë rrespektuar distancën e nevojshme si dhe duke respektuar sigurinë e ushqimit
- **Hyrja dhe dalja** nga shkolla dhe qëndrimi në oborr:
  - Hyrja për ciklin parafillor është e veçantë tek hyrja e klasës parafilllore. Nxënësit dalin në oborrin e përcaktuar për parafillor i cili është i ndarë nga ciklet tjera;
  - Hyrja për ciklin e ulët është e veçan nga ana e sallës së ushqimit. Nxënësit dalin në oborrin e përcaktuar për ciklin fillor i cili është i ndarë nga ciklet tjera;
  - Hyrja për ciklin e mesëm të ulët dhe të lartë është e veçantë nga hyrja kryesore, por e kufizuar me katin e poshtëm. Nxënësit dalin në oborrin e përcaktuar për ciklin fillor i cili është i ndarë nga ciklet tjera;
  - Prindërit dorëzojnë fëmijët e tyre para hyrjeve respektive sipas niveleve dhe nuk lejohen të hynë brenda.
- **Maskat:** Nxënësit i sjellin maskat me vete, por edhe shkolla ka siguruar fond të mjaftueshëm të maskave rezervë;
- **Zëvendësimi i mësimdhënëseve:** Është bërë plani për zëvendësimin eventual të arsimtarëve në rast të sëmundjeve si dhe është në proces rekrutimi i stafit ndihmës për arsimtarët.





## Krijo të ardhmen tënde!

**SKENARI B:** Shkolla beson se ky skenar nuk është i nevojshëm për shkollën tonë, sepse shkolla ka hapërsirë dhe staf të mjaftueshëm që brenda një ndërrimi ta mbajë mësimin e plotë.

**SKENARI C.** Shkolla është e përgaditur plotësisht për këtë skenar:

- Shkolla ka WEB faqen dhe platformën e vet për mësimin në distancë, Platformë e integruar digjitale për mësim dhe e-school të "Gjimnazit Cambridge" (<http://ww.gjimnazicambridge.online>).
- Platforma bazohet në MOODLE, por është e adaptuar për nevojat e shkollës. Ajo në vetë përfshinë ditarin elektronik, komunikimin dhe dhënjen e detyrave nxënëse, si dhe video komunikimin në kohë reale.
- Është bërë trajnimi i arsimtarëve si dhe është testuar platforma
- Janë blerë përmbajtje mësimore me video sipas kurrikulës së Kosovës për klasët 1-9 për të gjitha lëndët.

## Task Forca mbikqyrëse dhe koordinuese

Task Forca mbikqyrëse dhe koordinuese do të jetë në komunikim të vazhdueshëm me akterët e brendshëm të shkollës dhe me institucionet komunale dhe qendrore, ato arsimore dhe shëndetësore, për monitorimin e zbatimin e të gjitha udhëzimeve të lëshuara nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës, për menaxhimin e Pandemisë COVID-19 në shkollë.

Grupi do jetë në përbërje të:

1. Jakup Beqaj – Drejtor i Shkollës.
2. Besim Beqaj – Kryetari i Këshillit Drejtues.
3. Muharrem Kukalaj – Kryetari i Këshillit të Mësimdhënësve.
4. Arsim Avdija – Kryetar i Këshillit të Prindërve.
5. Diell Likaj – Kryetari i Këshillit të Nxënësve.
6. Qendrim Gërvalla – Kordinator për Teknologji.
7. Drita Maloku – Mjeke.
8. Arlind Vokshi – Përfaqësues për Logjistikë.

Task forca takohet çdo të premte pas përfundimit të mësimit dhe analizon mbarëvajtjen e punës si dhe rrespektimit të masave mbrojtëse dhe bën përgaditjet për javën vijuese. Në rast të nevojës ata takohen edhe me shpesh. Task Forca do të monitorojë mbarëvajtjen e procesit gjatë gjithë orarit mësimor dhe do sigurohet që të rrepektohen të gjitha rekomandimet e dhëna nga MASH.



+383 44 138 336  
+383 49 554 500



info@gjimnazicambridge.com  
www.gjimnazicambridge.com



Rr. Muharrem Mitrovica  
pn. 30 000 Pejë



## Krijo të ardhmen tënde!

### Ambulanca e shkollës

Ambulanca e shkollës do të jetë në shërbim të monitorimit të gjendjes shëndetësore të nxënësve. Dr. Drita Lokaj në vazhdimësi do të përcjellë paraqitjen eventuale të simptomave, për ti referuar pastaj për tretman shëndetësor në institucionet shëndetësore.

### Matja e temperaturës

Secilit nxënës dhe gjithë stafit të shkollës, për çdo mëngjes, në hyrje të shkollës do ti kontrollohet temperatura. Secili që ka temperaturë 38 °C, do të referohet për tretman shëndetësor dhe nuk do të lejohet brenda shkollës.

### Kufizimi i lëvizjeve në shkollë dhe organizimi i hyrjeve

Për qëllim të ruajtjes së shëndetit do të kufizohet lëvizja brenda dhe jashtë objektit të shkollës. Lëvizjet do të jenë minimale, vetëm atëherë kur janë të domosdoshme, si dhe duke shmangur lëvizjen e të gjithë nxënësve në kohë dhe drejtim të njëjtë.

### Qëndrimi në shtëpi kur është i nevojshëm

Secili, duke përfshirë ësimdhënësit, nxënësit, stafin administrativ dhe stafin tjetër ndihmës, në rast se testohen pozitiv me COVID-19, ndjehen të sëmurë ose që kohët e fundit kanë pasur kontakte të ngushta me një person me COVID-19 do të urdhërohen për të qëndruar në shtëpi.

Do të ndjekin procesin mësimor virtualisht në distancë përmes Platformës së integruar digjitale për mësim dhe e-school të "Gjimnazit Cambridge" (<http://www.gjimnazicambridge.online>).

### Transporti për në shkollë

Nxënësit që përdorin transportin e shkollës do të obligohen të mbajnë maskën gjatë gjithë kohës në autobus, të mbajnë distancën dhe të shmangin kontaktin e afërt me shokët/shoqet në autobus. Hyrja dhe dalja nga autobusi të bëhet me radhë, duke respektuar distancën prej 1.5 metra.



+383 44 138 336  
+383 49 554 500



info@gjimnazicambridge.com  
www.gjimnazicambridge.com



Rr. Muharrem Mitrovica  
pn. 30 000 Pejë



## Krijo të ardhmen tënde!

### Masat higjienike dhe mbrojtëse, pastrimi dhe dezinfektimi i duarve

Bartja e maskës është obligative për secilin, gjatë gjithë kohës. Stafi mësimdhënës duhet të mbajnë edhe mburojë të plastikës dhe mos të lëvizin në klasë gjatë mësimdhënies. Secili duhet ta ketë maskën adekuate personal, shkolla do të mbajë një sasi të rezervës për raste të veçanta.

Shkolla vendos në disa ambiente dezinfektues për duar, pajisë të gjitha toaletet me sapun për duar dhe tharëse të duarve. Stafi dhe nxënësit janë të obliguar që disa herë gjatë ditës të pastrojnë dhe dezinfektojnë duart, duke ruajtur distancën dhe shmangur kontaktin.

Secili duhet të mbuloj me brryl fytyrën gjatë kollitjes dhe teshtitjes. Mos të preket fytyra.

Ambientet e shkollës vazhdimisht do të dezinfektohen, jo në prezencë të nxënësve.

Mjetet shkollore duhet të jenë personale dhe mos të preken nga disa nxënës.

Gjithashtu, inkurajohet stafi dhe nxënësit të kenë me vete ujë personal për pije, në mënyrë që të shmangen prekjet e dispenserëve të ujit.

Shkolla ka ndërmarrë të gjitha masat e përcaktuara me udhëzues dhe i ka krijuar të gjitha kushtet me infrastrukturë dhe me mjete higjienike si dhe ka:

- Informuar administratën e shkollës për të gjitha procedurat dhe ua ka dhënë të gjitha udhëzimet nga pika 2 e udhëzuesit të MASHT;
- Informuar mësimdhënësit e shkollës për të gjitha procedurat dhe ua ka dhënë të gjitha udhëzimet nga pika 2 e udhëzuesit të MASHT;
- Informuar stafin teknik të shkollës për të gjitha procedurat dhe ua ka dhënë të gjitha udhëzimet nga pika 2 e udhëzuesit të MASHT;
- Përgaditur listat e kontrollit dhe planin e pastrimit dhe dezinfektimit;
- Ka përgaditur vendosjen e shenjave të nevojshme në shkollës për ti mbajtur nxënësit vigjilent për nevojën e pastërtis personale, për distancën dhe për maskat;
- Do i vendosë në ambiente adekuate Rregullat e sjelljes brenda shkollës, rregullat në klasë, rregullat në sallën e mësimdhënësve, rregullat për personelin e shkollës.





## Krijë të ardhmen tënde!

### Organizimi i vitit shkollor

Këshilli i arimtarëve bashkë me drejtorinë e shkollës kanë bërë të gjitha përgaditjet për organizimin e mësimin sipas skenarëve. Masta që janë marrë në këtë drejtim janë si në vijim:

1. Janë hartuar planet e punës dhe informatorët për secilën lëndë mësimore bazuar në tre skenarët e paraparë;
2. Është hartuar orari mësimor i shkollës dhe është në proces hartimi i orarit për klasët. Ai është i gatshëm me datën 31.08.2020;
3. Është bërë plani i ushqimit sipas grupeve duke shmangur krijimin e grupeve të mëdha dhe duke ruajtur distancën e nevojshme në sallën e ushqimit;

### Shërbimi i ushqimit

Shërbimi i ushqimit do të organizohet në disa orare, me kapacitet të përgjysmuar të sallës së ushqimit, për të shmangur kontaktin dhe ruajtur distancën prej 1.5 metra.

Ushqimi do të shërbehet në racione individuale. Enët ku do të shërbehet ushqimi do të pastrohen në temperaturë të lartë, me pajisje automatike përkatëse, për të siguruar higjienë maksimale. Kuzhinieret do të përdorin maskë dhe dorëza, duke respektuar distancën dhe kushtet higjieniko-sanitare.

Orari i ushqimit:

1. Në orarin 11:00-11:30, ushqehen klasat Parafillorë, I, II, III, IV, V;
2. Në orarin 11:40-12:10, ushqehen klasat VI, VII, VIII, IX, X;
3. Në orarin 12:25-12:55, ushqehen klasët XI/1, XI/2, XII/1, XII/2.

**Vërejtje:** Orari i ushqimit mund rishikohet sipas nevojës nga Task Forca.

### Takimet, ngjarjet, kabinetet, vizitorët dhe vizitat jashtë shkollës

Kuzifohen takimet në numrin maksimal prej 5 personave, duke ruajtur distancën prej 1.5 metrave. Aesi nuk lejohen të qëndrojnë së bashku në ambientet e shkollës më shumë se 5 persona.

Nuk lejohen vizitorët brenda ambienteve të shkollës, përfshirë edhe prindërit. Gjithashtu, anulohen të gjitha vizitat e organizuara jashtë ambienteve të shkollës, duke rekomanduar vizita dhe takime virtuale.

Ndalohen ngjarjet sportive, kulturore, klubet e shkencës dhe letërsisë, artit dhe të tjera, të gjitha do të organizohen virtualisht.

Udhëzohen mësimdhënësit që mos ti vizitojnë kabinetet dhe laboratorët, për të shmangur lëvizjet e nxënëve dhe prezencën në të njëjtin ambient të nxënësve të ndryshëm.



+383 44 138 336  
+383 49 554 500



info@gimnazicambridge.com  
www.gimnazicambridge.com



Rr. Muharrem Mitrovica  
pn. 30 000 Pejë



## Krijo të ardhmen tënde!

### Kujdesi për shëndetin mendor dhe fizik

Shkolla do të ketë të angazhuar psikologun, për tu kujdesur për shëndetin mendor të nxënësve, duke marrë parasyshë ngarkesën që mund të sjellë kjo situatë pandemike të fëmijët.

Gjithashtu, mësimdhënësit e edukatës fizike do të stimulojnë aktivitete të përmirësimit të sistemit të frymarrjes dhe ushqimit të shëndetshëm.

### Menaxhimi i situatës në rast të ndonjë rasti me virus

Task Forca mbikqyrëse dhe koordinuese do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e situatës në rast të paraqitjes së ndonjë rasti pozitiv me virusin COVID-19.

Vendoset në një ambient të ndarë. Njoftohet prindi. Do të organizohet transporti me ambulancë të kujdesit emergjent të qytetit, pastaj do të izoloohen ambientet ku ka qëndruar i/e infektuari/ja për të bërë dezinfektimin profesional.

Do të bëhet zëvendësimi i menjëhershëm, në rast se është staf mësimdhënës, deri në periudhën e shërimit, kurse për nxënës varësisht nga gjendja shëndetësore do të udhëzohen për mësim online nga distanca.

Personat me të cilit ka pasur kontakt i/e infektuari/ja duhet të informohen dhe përcillet gjendja e tyre shëndetësore për një periudhë të caktuar. Në raste të caktuara, me konsultimin e personelit shëndetësor të udhëzohen për qëndrim në shtëpi.

Task Forca mbikqyrëse dhe koordinuese gjithashtu informon institucionet kompetente.

### Rregullat në oborrin e shkollës

Prindërit që sjellin fëmijët vetë në shkollë duhet të dorëzojnë ata në oborrin e shkollës dhe asesi nuk janë të lejuar të futen në ambientet e shkollës.

Në oborr duhet të respektohet distanca minimale prej 1.5 metrave dhe ndalohet rreptësisht grumbullimi i nxënësve dhe stafit.

Nëse disa nxënës arrijnë në institucionin arsimor në të njëjtën kohë, duhet të sigurohet një sistem kontrolli në mënyrë që të sigurohet distanca prej së paku 1.5 m.

Të shmangët frekuentimi i hapësirave të mbyllura përreth shkollës (lokale, dyqanet, kafiteritë etj.). Maska është obligative brenda dhe jashtë shkollës, për të gjithë.



+383 44 138 336  
+383 49 554 500



info@gimnazicambridge.com  
www.gimnazicambridge.com



Rr. Muharrem Mitrovica  
pn. 30 000 Pejë



## Krijo të ardhmen tënde!

### Rregullat brenda shkollës

Në hyrje të shkollës, hyrje të korridoreve dhe në çdo klasë të vendosen materialet/posterët informues për masat mbrojtëse anti COVID-19 (etiketa e larjes së duarve, etiketa e vendosjes së maskës, etiketa e kollitjes dhe teshtimat me mbrojtje). Protokolli dhe masat anti COVID-19, t'u shpërndahen ose të paraqiten në hapësirë të dukshme.

Dyert e klasave të hapen dhe mbyllen nga mësimmhënësi. Nxënësit të udhëzohen mos të prekin dyert dhe dritaret.

Dalja në pushime të jetë e organizuar në mënyrë që mos dalin të gjitha klasat në të njëjtën kohë.

### Rregullat në klasë

Gjatë gjithë kohës nxënësit dhe personeli duhet të sigurojnë një distancë sigurie prej së paku 1.5m. Në parim, nuk është gjithmonë e mundur të ruhet distanca, sidomos për fëmijet që janë në klasë parafillore, klasë të parë, apo edhe me nxënësit me nevoja të veçanta. Në keto raste, sidomos gjatë shërbimeve të nevojshme mbështetëse (p.sh. ndihma gjate detyrave apo kërkesave tjera), ku nuk është e mundur të sigurohet/ruhet distanca fizike, kontakti me fytyrën në të njëjtin nivel të fytyrës duhet të shmangët dhe të përdoren dezinfektuesit sa më shpesh që është e mundur.

Pas çdo ore mësimore, mësimmhënësi duhet të hap dritaret që të bëhët ajrosja e ambientit të klasës. Dritaret duhet të mbahen të hapura gjatë tërë kohës nëse këtë e lejojnë kushtet atmosferike. Të zgjaten pushimet në mes orëve të mësimt.

Kur përdoren materiale dhe pajisje të riciklueshme dhe mjete me të cilat punojnë disa nxënës, nxënësit duhet të lajnë duart para dhe pas përdorimit të tyre.

Çdo nxënës/e duhet të kujdeset personalisht për pastërtinë e bankës ku është i/e ulur.



+383 44 138 336  
+383 49 554 500



info@gimnazicambridge.com  
www.gimnazicambridge.com




Rr. Muharrem Mitrovica  
pn. 30 000 Pejë

## Krijo të ardhmen tënde!

### SKEMA A

Klasa është riorganizuar duke marrë parasysh dimensionet mesatare të klasave. Në raport zig-zak sigurohet distancë mes ulseve të secilit nxënës. Kjo klasë ka kapacitet për 15 nxënës, në rast se klasa të tjera kanë dimensione më të mëdha atëherë riorganizimi mund të bëhet edhe për 20 nxënës në total.



### Rregullat në sallën e mësimdhënësve

Numri i lejuar i personave që mund të jenë të pranishëm në sallën e mësimdhënësve në të njëjtën kohë, përcaktohet nga menaxhmenti duke marrë parasysh hapësirën e sallës dhe respektimin e distancës 1.5m dhe mbajtjen e maskave. Nëse është e nevojshme dhe e mundur, klasat apo kabinetet tjera duhet të përshtaten si hapësira pune për mësimdhënësit.

Mbledhjet dhe takimet mund të mbahen në mënyrë virtuale, në mënyrë që të shmangët pjesëmarrja jo e domosdoshme fizike.

Stafi duhet të:

- Mbajë maskën gjithë kohës;
- Uniformat të lahen një herë në ditë (të paktën 60 gradë);
- Dezinfektuesit e duarve të përdoren rregullisht;
- Sipërfaqet / tavolinat duhet të pastrohen rregullisht me dezinfektues sipërfaqësor;
- Të ruaj distancën minimale prej 1.5 metra.





## Krijo të ardhmen tënde!

### Masat higjienike në ndërtesë

Të gjitha nyjet sanitare duhet të jenë të pajisura me ujë të rrjedhshëm dhe me sapun të mjaftueshëm.

Të gjitha hapësirat/ klasat duhet të ajrosen për të paktën pesë minuta pas çdo ore mesimore.

Personeli teknik duhet të informohet me udhëzuesin dhe të ndjek masat dhe rregullat e përcaktuara.

Të behet plani i pastrimit, gjithashtu duhet të bëhet një listë se kur dhe nga kush është kryer pastrimi.

Të paktën një here në ditë duhet të bëhet pastrimi i plotë i të gjitha hapësirave në të cilat janë vendosur nxënësit, personeli pedagogjik dhe administrativ. Kur shfrytëzohen hapësirat, siç janë sallat e edukatës fizike, menjëherë pas përdorimit duhet të dezinfektohen. Koshat e plehrave duhet të zbrazen çdo pushim pasi të kenë dalur nxënësit.

Dezinfektimi/pastrimi i sipërfaqeve ose hapësirave që frekuentohen nga numri më i madh i personelit dhe nxënësve duhet të kryhet disa herë në ditë (p.sh. dorezat e dyerve, çelësat e dritës, tastierat dhe minjtë e kompjuterit).

Dezinfektuesit e duarve mbahen nën kujdestarinë e mësuesve përkatës dhe përdoren vetëm nën mbikëqyrjen e tyre.

**Vërejtje:** *Plani i veprimit është dokument dinamik dhe ai do rishikohet sipas nevojës nga Task Forca.*



+383 44 138 336  
+383 49 554 500



info@gjimnazicambridge.com  
www.gjimnazicambridge.com



Rr. Muharrem Mitrovica  
pn. 30 000 Pejë